

PKR.nr.310/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga trupi gjykues prej tre gjyqtarëve profesionistë, përkatësisht gjyqtari Naser Foniqi – kryetar i trupit gjykues dhe Hamdi Ibrahim e Vehbi Kashtanjeva, anëtarë të trupit gjykues, me procesmbajtësen Sevdije Breznica, në çështjen penale të të akuzuarit B. B, i akuzuar për shkak të veprave penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422, par. 2, pika 2.1, lidhur me par. 1 të KPRK dhe Zbulimi i fshehtësisë zyrtare, nga neni 433, par. 1, të KPRK, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/ Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr.428/2015, të datës 20.05.2016, në shqyrtimin gjyqësor, të hapur, të mbajtur më datat: 11.10.2017; 07.12.2017; 05.03.2018 dhe 06.03.2018, në të cilin ishin të pranishëm: Prokurori i shtetit Kujtim Munishi; i akuzuari B.B, me mbrojtësin avokat S.M, sipas autorizimit dhe dëshmitarët B.H dhe B.C, pas shqyrtimit gjyqësor, me datë 09.03.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B.B, i biri i A dhe H , e vajzërisë B, i lindur me datë ... , në F, rr. "D. P", pa numër, ku edhe jeton, me numër personal ..., i martuar - baba i tre fëmijëve, ka të kryer Fakultetin Ekonomik dhe studimet master, i punësuar – realizon pagë mujore rreth... euro, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

I.

Konform nenit 364, par. 1 nënpar. 1.3, të KPPK,

LIROHET NGA AKUZA

S e p s e:

Ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare si udhëheqës i divizionit të prodhimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që me datë 04.02.2015, në Televizionin ..., ne emisionin "...", ka zbuluar publikisht të dhëna për procesin e punës së prodhimit të dokumenteve dhe shenjave – elementeve të sigurisë së pasaportave si: vendosjen e çipit, mënyrën e lansimit, qepjen, etj., të cilat procedura në vendimin numër 653/2013, të datës 01.10.2013, janë klasifikuar sekrete,-

- me këtë, kishte për të kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422, par. 2, pika 2.1, lidhur me par. 1 të KPRK
- Pasi që, nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.
- Shpenzimet gjyqësore, bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

II.

ËSHTË FAJTOR

- 1. S e p s e:** Si person zyrtar -udhëheqës i divizionit të prodhimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, ka bërë zbulimin e fshehtësisë zyrtare, në atë mënyrë që me datë 04.02.2015, në televizionin ..., në Prishtinë, në emisionin "...", ka diskutuar publikisht për procesin e punës së prodhimit të dokumenteve dhe shenjave –elementeve të sigurisë së pasaportave, siç janë: vendosja e çipit, mënyra e lansimit dhe qepja, të cilat procedura në vendimin numër 653/2013, të datës 01.10.2013, janë klasifikuar sekrete,-
- me këtë, ka kryer veprën penale Zbulimi i fshehtësisë zyrtare, nga neni 433, par. 1, të KPRK.

Në bazë të neneve: **41; 49; 50; 51; 52; 73 dhe 433, par. 1, të KPRK, si dhe nenit 365, të KPPK, të akuzuarit, i shqipton:**

DËNIM BURGIMI ME KUSHT

- **Në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj,** i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri në afat prej dy (2) viteve pasi ky aktgjykim ta merr formën e prerë, nuk kryen vepër tjetër penale.
- Obligohet i akuzuari që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **njëqind (100) €**, në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.

A R S Y E T I M I

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP.I.nr.428/2015, të datës 20.05.2016, ka akuzuar të pandehurin B.B, për shkak të veprave penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422, par. 2, pika 2.1, lidhur me par. 1 të KPRK dhe Zbulimi i fshehtësisë zyrtare, nga neni 433, par. 1, të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor, të datës 11.10.2017, pas leximit të aktakuzës, i pandehuri B.B, ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe është deklaruar i pa fajshëm për veprat penale për të cilat është akuzuar nga Prokuroria.

Në fjalën hyrëse Prokurori i shtetit, ka deklaruar se aktakuza PP.I.nr.428/2015 e dt.20.05.2016, është mbështetur dhe arsyetuar me prova materiale dhe jo materiale, përkatësisht nga dëshmia e dëshmitarit B.H, Rregullorja 03/11 për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun dhe Vendimi me nr.653/2013, i datës 15.08.2013, nga të cilat do të vërtetohet gjendja faktike e përshkruar në aktakuzë, **ndërsa në fjalën përfundimtare, prokurori ka theksuar se** gjatë seancave gjyqësore të cilat janë mbajtur në këtë çështje juridiko penale veprimet faktike të përshkruara në të dy pikat e dispozitivit të aktakuzës me numër PP.I.nr. 428/15, të datës 20.05.2016, u argumentuan dhe u bazuan në ligj dhe në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të cilat prova janë administruar nga gjykata.

Po ashtu, gjatë fjalës së tij, prokurori ka shtuar se faktin se i pandehuri B, ka kryer veprat penale nën pikën 1 dhe 2 të kësaj aktakuze është vërtetuar edhe nga vet prononcimi publik i tij në emisionin "...” në ..., të cilin prononcim e kemi dëgjuar edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku i pandehuri ndër të tjera duke folur për llojin e makinerisë, çipin, përshkrimin e materialit që përdoret për prodhimin e pasaportave, kualitetin e dobët, pastaj fletën e

laminimit, etj., ka bërë publikimin e paautorizuar të informacioneve sekrete, të sanksionuara sipas legjislacionit në fuqi, respektivisht vendimit numër 653/13, të datës 15.08.2013, për të cilin vendim ka qenë edhe vet i njoftuar, duke bërë nxjerrjen e dokumenteve zyrtare –pasaportave CPECMEN, jashtë hapësirave me nivel të lartë të sigurisë, pra jashtë departamentit të dokumenteve, dhe atë pa aprovim të mbikëqyrësve të tij, e pastaj duke e bërë publikimin në media. Prokurori i shtetit, ka thënë se Vendimi numër 653/13, i datës 15.08.2013, i sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në mënyrë decisive ka paraparë listën e dokumenteve të prodhuara dhe nivelin e klasifikimit të tyre, ku për Agjencionin e Regjistrimit Civil, ka paraparë elementet e sigurisë për dokumente civile dhe dokumente të tjera që prodhohen nga ART, duke i klasifikuar të njëjtat si sekret. Ndërsa cilat janë ato elemente të sigurisë te pasaportat elektronike të Republikës së Kosovës, edicioni qershor 2013, janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar me vendimin numër 284/2013, të datës 12.06.2013, të cilin e posedon gjykata dhe për shkak të klasifikimit të të njëjtës në shkallën “sekret” e njëjta nuk mund të bëhet publike dhe se i pandehuri me rastin e prononcimit publik në emisionin ... të përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, ka bërë edhe shkeljen e rregullores 03/11, për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun. Në fund të fjalës së tij, prokurori i shtetit ka kërkuar nga gjykata që duke marr për bazë të gjitha ato që u ceken dhe u elaboruan më lart, të akuzuarin B.B, ta shpall fajtor për dy veprat penale me të cilat ngarkohet sipas aktakuzës dhe të njëjtin ta dënoi sipas ligjit duke e obliguar me pagesën e shpenzimeve gjyqësore.

Mbrojtësi i të akuzuarit, në fjalën e tij hyrëse ka deklaruar se aktakuza e ngritur nga prokuroria është në tërësi e pabazuar dhe është hakmarrëse, për faktin se i mbrojturi i tij ka qenë drejtor në atë departament dhe Komisioni i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës, e ka anuluar konkursin dhe ka shpallë të paligjshëm me të cilin është emëruar apo zgjedhur drejtor dëshmitari i prokurorisë. Pastaj, mbrojtësi ka thënë se nuk bëhet fjalë për veprën penale shpërdorim i detyrës zyrtare dhe zbulimi i fshehtësisë zyrtare, me arsyetim se në intervistë në ... nuk është paraqitur asnjë sekret, por me plotë kuptimin e fjalës është denoncuar krimi, shpifja e dëshmitarit të të mbrojturit tim dhe se kjo është hakmarrje pas denoncimit publik se konkursi me të cilin është emëruar drejtor, është shpallur i paligjshëm dhe se në vendimin që ka cekur prokuroria janë të numëruara të gjitha elementet e sigurisë por askund nuk përmendet se nëse i lajmëron policinë dhe publikisht e denoncon krimin në mjetet e informimit është sekret. Po ashtu, mbrojtësi ka theksuar se të gjitha dokumentet e udhëtimit i kanë të vendosura në çip të gjitha të dhënat, të cilat janë të rregulluara me nenin 9 të Ligjit për Prodhimin e Pasaportave dhe Dokumenteve të udhëtimit, duke shtuar se sa i përket pretendimit të prokurorisë se në bazë të Vendimit nr.653/2013, të datës 15.08.2013 kemi shkelje dhe sa i përket mënyrës së komunikimit, në bazë të ligjit mbi shërbimin civil të RKS, komunikimi i pa autorizuar në mjete të informimit është një masë disiplinore dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet vepër penale. Ndërsa, në fjalën përfundimtare, mbrojtësi ka thënë se pas administrimit të provave dhe dëgjimit të dëshmitarëve është vërtetuar plotësisht se i mbrojturi i tij B.B, është i pafajshëm dhe nuk i ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar, duke shtuar se i njëjti në mënyrë profesionale i ka kryer detyrat e tij të punës. Po ashtu, mbrojtësi ka thënë se nuk qëndron pretendimi i prokurorisë së shtetit se i mbrojturi i tij i ka kryer veprat penale si në aktakuzë, për shkak të prononcimit të tij në emisionin “...” në ..., në të cilin emision ka folur për

kualitetin e pasaportave biometrike, llojin e makinerisë, çipin dhe materialin e përdorur për prodhimin e këtyre pasaportave, duke shtuar se asnjëri nga katër elementet e sigurisë nuk është paraqitur në këtë emision, me arsyetim se i mbrojturi i tij, nuk i ka ditur dhe nuk i di as sot këto elemente të sigurisë, sepse për të njëjtat elemente kanë njohuri vetëm sekretari i përhershëm, ministri i MPB dhe prodhuesi i pasaportave biometrike. Mbrojtësi ka shtuar se i mbrojturi i tij nuk ka paraqitur në publik asnjë sekret që ka të bëjë me pasaportat biometrike, siç parasheh vendimi numër 824/13, i datës 12.06.2013, dhe se plotësim

ndryshimi i Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit numër 03/L-217, neni 9, parasheh se të gjitha të dhënat në dokumentet e udhëtimit ruhen në çip në formë elektronike, e po ashtu, në dosjen e tenderit në faqen 29, pika 10.4 është përshkruar faqja e të dhënave, polikarboni me çip, dhe antenë të integruar, si dhe për jo polikarbon me çip, dhe antenë të integruar në kopertinën e parë, pastaj në dosjen e tenderit në faqen 32 dhe 33 sqarohet çipi dhe sistemi operativ i çipit, nga pika 11.3 deri 11.3.9, dhe nga pika 11.4.2, deri në pikën 11.4.9, duke shtuar se sistemi operativ i çipit në dosjen e tenderit ceket më shumë se 40 herë, e kjo dosje ka qenë e shpallur publikisht në web faqen e MPB dhe në njetet e informimit, pastaj në tender është cekur qepja, në faqen 32 dhe 33, pastaj pika 10.7 paraqet lidhjen e pasaportës, përkatësisht tekniken e lidhjes, ndërsa laminimi është rregulluar me udhëzimin administrativ 02/2013, në nenin 15, është rregullimi, invalidimi dhe shkatërrimi i pasaportave, ku në pikën 4, thuhet se pasaporta që dëmtohet gjatë personalizimit (laminimi i dobët, gabimi teknik) nga DPD, duhet të shkatërrohet nga komisioni i themeluar me vendim të MPB, duke shtuar se nuk kemi asnjë lloj sekreti apo keqpërdorimi të pozitës zyrtare apo autoriteti zyrtar nga i mbrojturi i tij B.B. Ndërsa, sa i përket vendimit numër 653/2013, të datës 15.08.2013, i marrë nga Sekretari i përhershëm i MPB, parashihen dokumentet të cilat janë sekret dhe atë në pikën 8 të vendimit thuhet “të dhënat elektronike për dokumente PKI-Infrastruktura e çelësit teknik, këtë sekret në emisionin ... i mbrojturi i tij nuk e ka përmendur asnjëherë, e po ashtu, nxjerrja e dokumenteve zyrtare-pasaportave “specimen” jashtë DPD pa aprovimin e mbikëqyrësit nuk qëndron, me arsyetim se i mbrojturi i tij e ka pranuar një pasaportë dhe një letërnjoftim “specimen” me fletë përcjellje (aprovim) nga zyrtari i lartë i prodhimit F.R, të cilat fletë përcjellje janë dorëzuar si prova në gjykatë.

Po ashtu, mbrojtësi ka theksuar se dëshmitari B.H, ka paraqitur dëshmi të rrejshme në polici, prokurori dhe në gjykatë, duke u përpjekur që ta vë në lajthim trupin gjykues, kur ka pretenduar se e ka dorëzuar vendimin numër 284/2013, të datës 12.06.2013, në të cilin parashihet se të dhënat elektronike për dokumente PKI sekret, që në gjuhën shqipe përkthehet si infrastrukturë e çelësit publik, nuk është përmendur në emision, dhe në fund të fjalës përfundimtare mbrojtësi ka propozuar gjykatës që në pajtim me nenin 364 par. 1, nënpar.1.3, të KPPK, të merret aktgjykim lirues për të pandehurin B.B, me arsyetim se nuk ka prova se i njëjti i ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar.

I pandehuri B.B, në fjalën e tij përfundimtare, ka theksuar se nuk ka çka të deklaroj më tepër sepse e gjitha është përfshirë në fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, janë dëgjuar dëshmitarë dhe janë administruar provat materiale të propozuara nga prokuroria në aktakuzë dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të paraqitura si në vijim:

- **Dëshmia e dëshmitarit B.H,** i cili ka deklaruar se në ditën kritike ka qenë duke punuar në MPB në pozitën e drejtorit të Departamentit për prodhimin e pasaportave në MPB prej dhjetorit të vitit 2012 dhe në atë kohë UNMIK, ka bërë një parapërgatitje që ky institucion të ketë tretman të veçantë, lëvizje të kufizuar, qasje në të dhënat personale të qytetarëve, monitorimin me kamera,

dhe dhënia e këtyre informacioneve jashtë nuk lejohej, duke shtuar se sipas Ligjit për klasifikimin e Informacioneve, është nxjerrë një vendim diku në vitin 2010 për pozitat e caktuara, është ndarë niveli i klasifikimit të informacionit, pastaj dëshmitari ka thënë se e njeh tani të akuzuarin B.B dhe se pozita e tij në institucionin e tyre fillimisht ka qenë zyrtar udhëheqës i qendrës për regjistrimin e automjeteve, pastaj ka ardhur si drejtor i departamentit në prodhimin e dokumenteve e pas një mosmarrëveshje me krye shefin e agjencionit në vitin 2011 është degraduar dhe është kthyer nga Drejtori në Udhëheqës të divizionit për prodhimin e dokumenteve. Pastaj, dëshmitari ka theksuar se sipas

procedurave asnjë informacion nuk guxon të jepet pa marrë leje nga menaxhmenti i lartë, ku përfshihet krye shefi i agjencionit, sekretari i përgjithshëm i MPB-së, apo edhe Ministri. Në pyetje të mbrojtësit të të akuzuarit B.B, av. S.M, dëshmitari ka thënë se përmendja e çipit nuk është sekret, por vendosja e tij në dokument është sekret, duke shtuar se nuk ka njohuri për vendimin 653/2016 të datës 15.08.2013, por e di se të gjitha pozitat për zyrtar e në rastin konkret edhe i akuzuari kanë dorëzuar emrat për të marrë lejen e sigurisë. Në pyetje nga i akuzuari, dëshmitari H. është përgjigjur se të gjitha të dhënat që i posedon departamenti i prodhimit të dokumenteve, ku hynë të dhënat e të gjithë qytetarëve, klasifikohen si të dhëna sekrete, dhe se asnjë dokumentacion nuk lejohet të nxirret jashtë departamenteve, i akuzuari i ka publikuar disa dokumente, të cilat shihen ne video incizim, ku paraqiten të dhënat e qytetarëve të cilat janë nxjerrë nga departamenti i prodhimit të dokumenteve, duke shtuar se PKI, është një sistem ku menaxhohen të dhënat elektronike, e përmes tij plotësohet çipi në pasaporta, letërnjoftime, përkatësisht dokumente, ndërsa ka thënë në fillim bëhet përgatitja teknike për dosjen e tenderit, pastaj shpallet tenderi, pasi të kryhen të gjitha procedurat formohet komisioni, i cili dizajnon vendosjen e çipit të sigurisë, e cila bëhet pasi të nënshkruhet kontrata sepse e njëjta është konfidenciale, në mes ministrisë dhe kompanisë.

- **Dëshmia e dëshmitarit B.C**, i cili ka deklaruar se në kohën kur B.B është pezulluar nga puna, ai-dëshmitari ka qenë ushtrues detyre i krye shefit të Agjencionit të Regjistrimit Civil (ARC) që nga 08.02.2012 deri më datë 08.02.2015, duke shtuar se me datë 04.02.2015 e ka parë emisionin televiziv “...” në ..., në të cilin si mysafirë ka qenë B.B, i cili me sa i kujtohet nuk ka folur për përmbajtjen e çipit, por ka folur vetëm për pasaportën biometrike e cila përmban çipin në kopertinë, ndërsa e kaluara e ka mbajtur në polikarbonat brenda në pasaportë, duke theksuar se dihet që çipi ose është në kopertinë ose në polikarbonat.
- transkripti i intervistës së dhënë nga i pandehuri B.B, në emisionin ... me datë 04.02.2016, në të cilin i njëjti publikisht ka zbuluar të dhëna për procesin e punës së prodhimit të dokumenteve dhe shenjave apo elementeve të sigurisë së pasaportave, si janë: vendosjen e çipit, mënyrën e laminimit dhe qepjen, të cilat procedura me vendimin numër 653/2013, e cila është provë materiale e radhës së propozuar të datës 01.12.2013, janë të klasifikuara si sekret.
- Vendimi numër 653/2013, i datës 15.08.2013, sipas të cilit zbulimi i të dhënave për procesin e punës së prodhimit të dokumenteve dhe shenjave apo elementeve të sigurisë së pasaportave, është klasifikuar si sekret.
- CD, e emisionit “...” në ..., me datë 04.02.2015, në të cilin paraqitet i akuzuari duke shpjeguar të dhëna për procesin e punës së prodhimit të dokumenteve dhe shenjave apo elementeve të sigurisë së pasaportave, si janë: vendosja e çipit, mënyra e laminimit dhe qepja e pasaportës.
- Dosja e tenderit për kontratën publike kornizë, nr. i prokurimit..., e datës 01.02.2013, në të cilën paraqiten: procedurat e tenderimit që përmbajnë udhëzime për përgatitjen e tenderit; draft kontrata që përmban kushtet kontraktuese të cilat duhet t'i pranoj tenderuesi që e merr kontratën dhe formulari i tenderit, d.m.th, dokumentet që duhet t'i paraqesin tenderuesit.

- Nga mbrojtja e të akuzuarit, i cili ka deklaruar se në vitin 2004 ka qenë koordinator i regjistrimit të automjeteve në F., pastaj në vitin 2010 ka kaluar në P. dhe është bërë drejtor me konkurs në departamentin e personalizimit të dokumenteve, i cili është i njëjtë me departamentin e prodhimit, vetëm se emërtimi ndryshon. Pastaj, i akuzuari ka thënë se ka dhënë intervistë në ... dhe për këtë është suspenduar nga pozita e drejtorit të departamentit të personalizimit ose prodhimit dhe se një muaj para se me dalë në "...", me email iu ka drejtuar ministrit S.H, sekretarit permanent dhe krye shefit të ARC, duke iu shprehur brengat se janë duke u dëmtuar si institucion, e pastaj është ftuar në ..., jo në cilësinë e zyrtarit të MPB, mirëpo për shkak të padisë të cilën e kishte bërë ndaj ministrit - tani i ndjerë B.R, dhe se në intervistë ishte pyetur për zbardhjen e të gjitha dëmeve që po i shkaktoheshin shtetit të Kosovës, dëmit material dhe moral, përkatësisht shkatërrimin e 17 mijë pasaportave, duke shtuar se Laminimi është një fletë e tejdukshme që i vendoset faqes së të dhënave të pasaportës, për ruajtjen e dokumentit, dhe parashihet në udhëzim administrativ, e po ashtu edhe qepja përmendet në dosje dhe specifikat e tenderit, ku përmendet vendosja e çipit dhe se shpallja e tenderit ka qenë publike, e në të cilën janë paraqitur të gjitha specifikat teknike, përkatësisht çipi, mënyra e laminimit dhe qepja kanë qenë në specifikat të dosjes së tenderit. I akuzuari është mbrojtur, se vet fakti që në ligj përmendet çipi, nuk ka bërë kurrfarë shkelje e as kurrfarë zbulimi të sekretit, me arsyetim se sekret është zbulimi i përmbajtjes së të dhënave në çip dhe se nuk është sekret laminimi-petëzimi i pasaportës, mënyra e qepjes. Në pyetje të Prokurorit të shtetit, i akuzuari ka thënë se "specimenti" është një shembull që iu jepet studentëve, personaliteteve të institucioneve të ndryshme të Republikës së Kosovës, dhe ai –specimenti nuk përmban elemente të sigurisë, ndërsa ka shtuar se nuk ka qenë i njoftuar me vendimin e ministrit se çka paraqet sekret në dokumentet e udhëtimit, duke shtuar se thëniet e tij se prodhuesi gjerman çipin e ka vendosur në kopertinë të pasaportës nuk ka qenë publike, por nuk ka qenë sekrete dhe se në vendimin e ministrit nuk specifikohet faqja ku vendoset çipi.

Pas vlerësimit të dëshmisë së dëshmitareve, administrimit të provave materiale dhe mbrojtjes së të akuzuarit, gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata e vërtetoi nga:

Sa i përket veprës penale si në dispozitivin e parë të aktgjykimit, gjykata ka vendosur ta liroj nga akuza të akuzuarin B.B, pasi që, me asnjë provë nuk është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422, par. 2, pika 2.1, lidhur me par. 1 të KPRK, duke pasur parasysh faktin se prokuroria me të njëjtin përshkrim e ka akuzuar të pandehurin për të dy veprat penale të paraqitura në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Po ashtu, gjykata ka vlerësuar, analizuar dhe

ka arritur në përfundim se i akuzuari B., nuk ka përfituar dobi pasurore për vete ose për personin tjetër apo nuk i ka shkakuar dëm personit tjetër, a as nuk i ka shkelur të drejtat e personit tjetër, përkatësisht i gjithë përshkrimi i dispozitivit të parë të aktakuzës ka të bëjë me zbulimin e të dhënave për procesin e punës së prodhimit të dokumenteve, dhe se në këtë përshkrim prokuroria nuk ka arritur të identifikojë shkeljet e tani të akuzuarit të paraqitura në dispozitivin e nenit 422 të KPRK.

Ndërsa, sa i përket veprës penale si në dispozitivin e dytë të aktgjykimit, përkatësisht Zbulimi i fshehtësisë zyrtare, nga neni 433, par. 1, të KPRK, gjykata ka vërtetuar se i akuzuari e ka kryer këtë veprë penale, e cila është vërtetuar me provat si në vijim:

- Dëshmitë e dëshmitarëve B.H dhe B.C, dëshmitë e të cilëve kanë qenë rrethanore, pasi që, ka pasur prova materiale me të cilat është vërtetuar gjendja faktike;
- Transkripti i intervistës së dhënë nga i pandehuri B.B, në emisionin ... me datë 04.02.2016; Vendimi numër 653/2013, i datës 15.08.2013; CD, e emisionit ... në ..., me datë 04.02.2015, me arsyetimet e shënuara si më lart dhe
- Nga mbrojtja e të akuzuarit, i cili ka pranuar se ka dhënë intervistë në ..., dhe se aty ka përmendur vendosjen e çipit, lidhjen, qepjen dhe laminimin e pasaportave, duke pretenduar se nuk ka zbuluar të dhëna sekrete, pasi që shpallja e tenderit për këto pasaporta ka qenë publike, dhe aty janë paraqitur të gjitha specifikat teknike, duke përfshirë çipin, mënyrën e laminimit dhe qepjen.
- Sipas provave materiale dhe thëniet e të akuzuarit, është vërtetuar se i njëjti, ka dhënë intervistë në emisionin “...” në ..., dhe aty ka përmendur-diskutuar për elementet e sigurisë në pasaporta, përkatësisht vendosjen e çipit, lidhjen, qepjen dhe laminimin e pasaportave, të dhëna këto të klasifikuara si sekrete, me vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, Nr.653/2013, të datës 15.08.2013, sipas të cilit është miratuar lista e informacioneve të prodhuara nga MPB, si dhe niveli i klasifikimit të këtyre informacioneve, e cila i është bashkangjitur këtij vendimi me të cilin obligohen autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tij dhe i cili ka hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit nga sekretari i përgjithshëm. Sipas këtij vendimi, sa i përket Agjencisë së Regjistrimit Civil, në pikën 1 të listës janë paraqitur elementet e sigurisë për dokumente civile dhe dokumente tjera që prodhohen në ARC, të klasifikuara si sekrete. Edhe në listën si më lart, në faqen 4, nr. 46 të saj është paraqitur se Udhëheqësi i divizionit të prodhimit, pozitë të cilën e ka mbajtur tani i akuzuari B.B, nivelin e klasifikimit ka pasur “sekret”.
- Sipas nenit 7, par. 4, të ligjit nr. 03/l-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë, kompetencë për klasifikim në nivelin “Sekrete”, “Konfidenciale” dhe “E kufizuar”, kanë sekretarët e përhershëm, krye shefat ekzekutivë apo drejtorët ekzekutivë të institucioneve publike dhe pozicionet e barasvlershme me ta, përveç nëse ata ia delegojnë këtë kompetencë zyrtarëve të lartë vartës. Andaj, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, vendimin Nr.653/2013, të datës 15.08.2013, e ka marrë sipas dispozitave ligjore të paraqitura si më lart.

Prandaj, nga dëshmia e dëshmitarëve të dëgjuar, provat materiale të administruara dhe mbrojtjes së të akuzuarit, duke i analizuar secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku, është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit B.B, ekzistojnë të gjitha elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprës penale Zbulimi i fshehtësisë zyrtare, nga neni 433, par. 1, të KPRK, kështu që, të njëjtin gjykata e ka shpallur fajtor, pasi më parë ka gjetur se është penalisht i përgjegjshëm dhe i ka shqiptuar dënim si në dispozitivin e II, të këtij aktgjykimi.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si: intensiteti i rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur; sinqeritetin e treguar gjatë shqyrtimit gjyqësor, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, përkatësisht faktin se i akuzuari gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ka pretenduar se paraqitjen në emisionin “...” e ka bërë për t’i paraqitur vërejtjet për mangësitë dhe dobësitë e vërejtura gjatë prodhimit të pasaportave dhe duke pasur parasysh sjelljen e

mëparshme të të akuzuarit, për të cilin sipas evidencës së kësaj gjykate ndaj tij nuk ka akuza të tjera të ngritura dhe nuk është gjykuar më parë, ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese, prandaj të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar kundër tij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41, të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, **për veprën penale si në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit**, u mor në bazë të nenit 454, par.1 të KPPK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, **për veprën penale si në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit**, u mor në bazë të nenit 453, par.1 të KPPK.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të neneve 364, par. 1 nënpar. 1.3, dhe 365, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 15.03.2018.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/ DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.310/16, datë 09.03.2018.

Sekretare juridike
Sevdije Breznica

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Naser Foniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, me seli në Prishtinë.